

# **STATUT**

## **I SHOQËRISË "M&M MEDICAL" SHPK**

### **KREU I**

#### **THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

##### **NENI 1**

###### **Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

- 1.1. Sot më datë 14 Dhjetor 2023, unë themeluesi kam krijuar Shoqërinë me Përgjegjesi të Kufizuar me emrin "M&M Medical" SHPK.
- 1) Shoqëria është themeluar nga Ortaku i Vetëm Egresa Mavriqi, atësia Isuf, e datëlindjes 25.12.1979, lindur dhe banuese në Tiranë, identifikuar nga karta e identitetit ID: H962250260, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar .
- 1.2. Shoqëria "M&M Medical" SHPK është krijuar në përputhje me Ligjin Nr.9901 dt.14/04/2008,"Per Shoqëritë Tregtare"(i ndryshuar), për të ushtruar veprimtari të përbashket sipas parashikimeve të bëra në këtë Statut.
- 1.3. Emërtimi i shoqërisë është "M&M Medical" SHPK. Shoqëria, e përcaktuar në nenin 1 të këtij statuti është krijuar me mjetet në pronësi private të themeluesve.

##### **NENI 2**

###### **Objekti i veprimtarisë së shoqërisë**

Objekti i Shoqërisë është si më poshtë vijon:

- 2.1. Klinikë Dentare, Ecografi, Laborator dentar, përfshi të gjitha shërbimet stomatologjike që lidhen me këtë fushë;
- 2.2. Trajtime mjekësore estetike të fytyrës dhe trupit.
- 2.3. Veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese - gjeneratore me rreze X;
- 2.4. Import-Eksport të Materialeve dhe Pajisjeve Dentare, Farmaceutike dhe Mjekësore;
- 2.5. Import - Eksport të medikamenteve të ndryshme mjekësore dhe farmaceutike;
- 2.6. Blerje dhe shitje me shumicë dhe pakicë të pajisjeve dhe materialeve dentare dhe mjekësore;
- 2.7. Aktivitete të kualifikimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë
- 2.8. Shërbime Hotelerie përfshirë edhe çdo veprimtari tjetër plotesuese që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me veprimtarinë e menaxhimit të strukturave të hotelërisë dhe ofrimit të shërbimeve te hotelërisë;
- 2.9. Shërbime Bar-Kafe;



- 2.10. Shoqëria mund të kryejë cdo veprimtari tjetër plotësuese që ka lidhje me aktivitetet e mësipërme, si dhe aktivitete të tjera që edhe pse nuk ka lidhje me sa është parashikuar më sipër, nuk përben një veprimtari të ndaluar me ligj dhe që është në funksion të përmbushjes së objektit të Shoqërisë.

### NENI 3

#### Kohëzgjatja

- 3.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin pa afat të përcaktuar.

### NENI 4

#### Selia e shoqërisë

- 4.1. Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: **Tiranë, Bashkia Tiranë, Njësia Bashkiake nr.9, Rr.Jordan Misja, Njësi, ZK- 8330, Nr.pasurie 8/160-N13.**
- 4.2. Ajo mund të çelë filiale ,degë dhe përfaqësi në qytete të tjera të Shqipërisë, në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.
- 4.3. Adresa e komunikimit elektronik(email) është: [mm.medical23@gmail.com](mailto:mm.medical23@gmail.com).

## KREU II

### KAPITALI

#### NENI 5

#### Kapitali themeltar

- 5.1. Kapitalit themeltar i shoqërisë është **100.000,00 (njëqindmijë) lekë.**
- 5.2. Ortaku i Vetëm i Shoqërisë është **Egresa Mavriqi, që zotëron 100% të kapitalit të përbërë nga 1 ( një) kuotë me vlerë 100.000 lekë.**
- 5.3. Ky kapital është i ndarë në **1(një) pjesë.** Kuotat e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve. Kuotat e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, pasi të marrin miratimin e ortakëve të tjerë të shoqërisë, duke respektuar të drejtën e parablerjes, kur transferimi behet me anë të shitjes.

#### NENI 6

#### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 6.1. Kapitali i shoqërisë mund të rritet pa kufij nëpërmjet kontributeve në para dhe kontributëve në natyrë.
- 6.2. Në rast të rritjes së kapitali, të gjithë Ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë rritjen në raport me pjesët e kapitalit në të zotëruara.





- 6.3. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 6.4. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit sipas Nenit 11, pika.1.
- 6.5. Në të gjitha rastet zvoglimi i kapitalit i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqsojnë.
- 6.6. Në asnjë rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 6.7. Për procedurat e rritjes apo zvogëlimit të kapitalit Asambleja e Ortakëve emëron një Ekspert të licensuar sipas legjislacionit shqiptar(Auditues Ligjor).

### **NENI 7** **Trasferimi i kapitalit**

- 7.1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) Shitblerjes;
  - c) Dhurimit;
  - d) Trashëgimnisë;
  - e) Çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj;
- 7.2. Pjesët e kapitalit themeltar janë lehtësisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, përsa kohë nuk parashikohet ndryshe në statut.
- 7.3. Pjesët e kapitalit themeltar janë lehtësisht të transferueshme në rrugë trashëgimnie.

## **KREU III** **ORGANET VENDIMORE DHE DREJTUESE**

### **NENI 8**

- 8.1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 8.2. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) Ndryshimin e Statutit;
  - c) Emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve;
  - d) Emërimin e shkarkimin e Likujdatorit dhe Audituesit Ligjor;
  - e) Përcaktimin e shpërblimeve për Administratorët, Likujdatorin dhe Audituesit Ligjor;
  - f) Mbikqyrjen dhe zbatimin e politikave tregtare nga administratorët , përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;



- h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - i) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - l) Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
  - m) Çështjet e tjera të parashikuara nga ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” apo statuti;
- 8.3. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 8.4. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 8.5. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 8.6. *Të drejtat e Asamblesë se Ortakeve do te ushtrohen nga Ortaku i Vetëm për aq kohë sa shoqëria do të jetë me një ortak..*

## NENI 9

### Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve

- 9.1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike.
- 9.2. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 9.3. Lajmërimi bëhet nga administratori ose në mungesë të tij nga një apo disa ortakë që përfaqësojnë të paktën 5 % të kuotave të kapitalit themeltar nëpërmjet kërkesës me shkrim drejtuar administratorit.
- 9.4. Në rast se Administratori refuzon apo nuk fillon procedurën për thirrjen e Asamblesë se Ortakeve, ortakët që kanë kërkuar mbajtjen e asamblesë, mund të bëjnë vetë lajmërimin e ortakëve të tjerë, duke respektuar procedurat e parashikuara në këtë nen.
- 9.5. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas parashikimeve të mësipërme të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët që janë të pranishëm dhe plotësojnë kuorumin e nevojshëm për vendimarrje janë dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
- 9.6. Asambleja e ortakëve duhet të thirret të paktën një herë në vit, brenda 6(gjashtë) muajve nga mbyllja e periudhës ushtrimore apo sipas rasteve të parashikuara në ligj.
- 9.7. Mbledhjet mbahen në selinë e shoqërisë, apo edhe në një vend tjetër, i cili u bëhet i ditur paraprakisht ortakëve.





## NENI 10

### Kuorumi

- 10.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50 për qind të kuotave.
- 10.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 10.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorunit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
- 10.4 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendime dhe disponon një numër votash të barabartë me kuotat e kapitalit themeltar që ai zotëron.

## NENI 11

### Marrja e Vendimeve

- 11.1 Asambleja e përgjithshme vendos me  $\frac{3}{4}$  (tri të katërtat) e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për:
  - a) Ndryshimin e statutit;
  - b) Zmadhimin, apo zvogëlimin e kapitalit;
  - c) Shpërndarjen e fitimeve.
  - d) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 11.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës që zotërojnë 50% të kuotave të pronësisë, për çështje te tjera si:
  - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin e Likujdatorit dhe të Audituesve Ligjorë;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likujdatorët, ekspertët dhe audituesit ligjorë ;
  - e) mbikqyrjen dhe zbatimin e politikave tregtare nga administratorët;
  - f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g) marrjen e kredive dhe huave;
  - h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - i) miratimin e transferimit të kuotave të shoqërisë tek palet e treta, jashtë radheve të ortakëve;
  - j) krijimin e të drejtave dhe detyrimeve që e angazhojnë shoqërinë në blerjen e aseteve apo miratimin e projekteve të zbatimit, për vlera financiare që tejkalojnë shumën 10 mijë euro;



- k) themelimin, blerjen ose shitjen e filialeve, degëve apo zyrave të përfaqimit të shoqërisë;
  - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - m) të tjera që parashikohen nga ligji apo statuti;
- 11.3 Vendimet e marra nga Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë për pikat 11.1 dhe pika 11.2, gërma b), c), f) dhe k), duhet të depozitohen pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në Ekstraktin e Rregjistrimit të Shoqërisë;
- 11.4 Asambleja e Ortakëve cakton një Sekretar i cili mban procesverbalin e mbledhjes dhe administron vendimet. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga Ortakët me numrin më të madh të kuotave të pronësisë e në mungesë të tij nga Ortaku që renditet pas tij me kuota pronësie, si dhe Sekretari;

## NENI 12


### Përfashtimi nga e drejta e votës

- 12.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendime për:
- a) Vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) Ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - d) Dhënien ose jo të përfitimeve të reja;
- 12.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, përfaqësuesi vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi ashtu si ortaku të cilin përfaqëson.

## NENI 13

### Administrimi i shoqërisë

- 13.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme.
- 2) Administratori i shoqërisë është **Egresia Mavriqi, atësia Isuf, e datëlindjes 25.12.1979, lindur dhe banuese në Tiranë, identifikuar nga karta e identitetit ID: H962250260.**
- 13.2 Afati i ushtrimit të detyrës nga administratori është **5 vjet** me të drejtë ripërtëritje.
- 13.3 Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 13.4 Funkzioni i Administratorit përfundon:
- a. me mbarimin e afatit 5 vjeçar;
  - b. nëpërmjet shkarkimit me vendim të ortakëve që përfaqësojnë më tepër se gjysmën e pjesës së kapitalit themeltar;
  - c. kur vete administratori jep dorëheqjen vullnetarisht.





- 13.5 Nga momenti i mbarimit të mandatit, shkarkimit, apo dorëheqjes administratori i vjetër do vazhdojë të përfaqësojë shoqërinë deri në emërimin e administratorit të ri, por pa patur të drejte të kryeje veprime tregtare.

#### NENI 14

##### Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit

- 14.1 Kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- 14.2 Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji dhe statuti ua kufizon atyre apo iu jep shprehimisht ortakëve;
- 14.3 Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- 14.4 Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, pasqyrat financiare, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim, brenda një afati prej gjashtë muajsh duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar;
- 14.5 Krijon një sistem të kontrollit të brendshëm dhe sinjalizimi për risqet që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- 14.6 Kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- 14.7 Te raportoje para Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
- 14.8 Të emërojë dhe të shkarkojë nga puna punëmarrësit e shoqërisë duke zbatuar procedurat e brendshme dhe kërkesat e Kodit të Punës të Republikës
- 14.9 Të japë urdhra dhe udhëzime punëmarrësve dhe të vendosë sanksione ndaj tyre, në përputhje me kontratat e punës dhe rregulloret e brendshme të shoqërisë;
- 14.10 Administratori duhet të drejtojë e të organizojë punën në mënyrë të tillë që të sigurojë suksesin e shoqërisë në veprimtarinë e saj ekonomiko-financiare;
- 14.11 Të zbatojë vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme, të dhëna brenda kompetencave të përcaktuara nga statuti i shoqërisë dhe legjislacioni në fuqi;
- 14.12 Administratori ka të drejta dhe detyrime të tjera të përcaktuara nga ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
- 14.13 Të përfaqësojë shoqërinë përpara organeve administrative, gjyqësore ose të tretëve, e realizon administratori personalisht ose nëpërmjet autorizimit të lëshuar nga ai. Në rast pengesash, si sëmundje, aksidente, udhëtime etj, administratori do të autorizojë një person tjetër për përfaqësimin dhe administrimin e shoqërisë.
- 14.14 Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:



- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  - b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 14.15 Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
- 14.16 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.
- 14.17 Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 15

### Përgjegjësitë e Administratorit

- 15.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 15.2 Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja e përgjithshme që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 15.3 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:
- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimit të shoqërisë në mjedis;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - d) të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
  - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 15.4 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.





- 15.5 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 15.1 e 15.2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- 15.6 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse në kundërshtim me dispozitat e Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe përcaktimeve në Statut, kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi pagueuse për të shlyer detyrimet;
  - d) jep kredi;
- 15.7 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.
- 15.8 Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.
- 15.9 Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

## **KREU IV** **VITI FINANCIAR-EKSPERTËT**

### **NENI 16**

#### **Viti Financiar dhe shpërndarja e fitimit**

- 16.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.
- 16.2 Përgjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.
- 16.3 Shoqëria miraton brenda 6-mujorit të parë të vitit pasardhës pas vitit raportues, raportin vjetor të veprimtarisë së shoqërisë hartuar nga Administratori, Pasqyrat Financiare të vitit raportues si dhe Raportin e Auditimit të hartuar nga Audituesi Ligjor.
- 16.4 Fitimet neto që rezultojnë sipas Pasqyrave Financiare të vitit raportues mund të shpërndahen ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.
- 16.5 Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj.  
b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.
- 16.6 Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 16.5 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.
- 16.7 Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e Çertifikatës së aftësisë paguese.
- 16.8 Administratorët, të cilët nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjen personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.
- 16.9 Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur, pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë.

#### NENI 17

##### Audituesit Ligjorë

- 17.1 Audituesi Ligjor i emëruar nga Asambleja e Ortakëve, ka për detyrë që të auditojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko financiare dhe ligjore të shoqërisë për vitin raportues, si dhe për periudha periodike në rastet kur ai është ngarkuar nga ana e ortakëve.
- 17.2 Në përfundim të auditimit, Audituesi Ligjor përgatit raportin e auditimit me shkrim dhe ja paraqet atë Asamblesë së Ortakëve, brenda afateve ligjore të parashikuara.

### **KREU V**

#### **PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

#### NENI 18

##### Prishja dhe Likuidimi

- 18.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë :
- 18.1.1 kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
  - 18.1.2 me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
  - 18.1.3 me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - 18.1.4 nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për më shumë se pesë vjet;
  - 18.1.5 me vendim të gjykatës;
- 18.2 Në këtë rast Asambleja e Ortakëve bazuar në vendimin me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo





dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër”.

- 18.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- 18.4 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
- 18.5 Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **NENI 19**

##### **Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

- 19.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

#### **NENI 20**

##### **Baza Ligjore**

- 20.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 20.2 Për çështje që nuk parashikohen dhe rregullohen nga ky statut vlejné dispozitat e Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”(i ndryshuar), Kodi Civil, si dhe çfarëdo aktet ligjore që rregullojnë këtë veprimtari.

#### **NENI 21**

##### **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

### **ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“M&M Medical ” SHPK**

**Egresa Mavriqi**

